



Pranuar / Dorezuar Prijmjen / Prudato Received / Dullvary	20.09.2022	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtetja Pislog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPROMSH/CK	5529/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.727/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A. Nr. 727/2022 të datës 23.08.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi nga Komuna e Prishtinës kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 19.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr. 727/2022 të datës 23.08.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 23.08.2022 me numër protokolli 4886/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore lidhur kompensimin për trustin pensional, gjatë të cilës periudhë ka punuar në Ministrinë e Infrastrukturës, në bazë kontratës për marrëveshje për shërbime të veçanta respektivisht nga data 08.07.2016 deri 30.09.2019 dhe 15.01.2020 deri 29.12.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova; Ankesën A. Nr. 727/2022 e datës 23.08.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Marrëveshje për shërbime të veçante e datës

08.07.2016; Marrëveshje për shërbime të veçante e datës 04.01.2017; Marrëveshje për shërbime të veçante e datës 03.04.2017; Marrëveshje për shërbime të veçante e datës 01.06.2017; Marrëveshje për shërbime të veçante e datës 01.11.2017; Marrëveshje për shërbime të veçante e datës 01.08.2017; dëshmi nga trusti pe periudhën nga data 25.06.2022, deri me datën 18.08.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i ka shqyrtuar pretendimit ankimore të ankuesit Kolegji pasi që i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit të gjitha provat dhe faktet relevante ka konstatuar së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës që ka dërguar ankuesi konstatohet që ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune në Ministrinë e Infrastrukturës përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta të cilat janë lidhur në kohën kur ka qenë i aplikueshëm Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili në nenin 12 paragrafit 4, ka përcaktuar se: *"Emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtë se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura "Marrëveshje për shërbime të veçanta" të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrime..."*, si rrjedhojë në bazë të nenit 12 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *"Në Shërbimin Civil të Kosovës ekzistojnë dy kategori të punësuarve: 1.1. pozitat e nëpunësve civilë të karrierës...dhe 1.2. pozitat e nëpunësve civilë të jo karrierës..."*, në këtë rast Kolegji i Këshillit, konstaton se Marrëveshjet për Shërbime të Veçanta nuk hyjnë në kuadër të shërbimit civil.

Po ashtu Kolegji lidhur me këtë çështje ju referua Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht nenit 2 paragrafi 3, i cili përcakton se: *"Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm, në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë"*, ndërsa neni 84 i të njëjtit ligj ka përcaktuar se: *"Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik"*.

Duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent të shqyrtoj dhe të vendos vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, ndërsa meqenëse marrëveshjet për shërbime të veçanta i nënshtrohen Ligjit për detyrimet, atëherë pala ankuese mund të filloj procedurën sipas Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve

Siç u tha më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër Nr. A.nr.727/2021

Rnshir KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe;
- Arkivit të KPMShCK-së